

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË,

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë penale e shkallës së parë, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarës V.D. nga Shtërpca, e cila sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.2965-1/14 dt.25.11.2015 ka kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Visar Musa dhe të akuzuarës V.D., me dt.21.01.2016 solli dhe publikisht komutoi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **V.D.** nga Shtërpca, data e lindjes..... në Ferizaj, nga i ati B. dhe e ëma D., e gjinisë S., serbe, shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë e dyë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, , e pa punë, e gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me dt.05.03.2012 në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Shtërpçë-QRA e ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtetë e paraparë të shërbej si provë në një dokument publik, në atë mënyrë që me qëllim që t'i ikë zhdoganimit dhe regjistrimit të rregullt të automjetit të markës "Ford Fiesta" ngjyrë e kuqe, me nr. të karrocërisë, viti i prodhimit 1990, përmes dokumentit të falsifikuar-librezës së qarkullimit të shtetit të Serbisë në emër të sajë të cilin më parë e kishte falsifikuar, ka arritur t'a regjistroj automjetin e sajë në QRA në Shtërpçë edhe pse e ka ditur se të njëjtat dokumente janë të falsifikuara.

- me çka ka kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata, në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 6, 11, 34, 41, 42, 43, 44 dhe 64 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarën e

G J Y K O N

Të akuzuarës **V.D.** i shqiptimet dënimi me burg prej 5 (pesë) muajshë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Në kuptim të nenit 60 të KPK-së të akuzuarës i shqiptohet edhe dënimi plotësues gjegjësisht marrja e sendit dhe atë dokumentet e falsifikuara-libreza, libreza e qarkullimit nr. dhe targa e regjistrimit

Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2965-1/14 dt.25.11.2015 me të cilën ka akuzuar V.D. nga Shtërpca, për veprën penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke proceduar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së më dt.21.01.2016 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Visar Musa dhe e akuzuara V.D..

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se e akuzuara në afatin ligjor së bashku me ftesën për shqyrtim fillestar e ka pranuar edhe aktakuzën sipas së cilës akuzohet.

Në shqyrtimin fillestar e akuzuara është udhëzuar në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPRK-së se ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen ose të mos përgjigjet në pyetje e gjykatës, e nëse deklarohet nuk ka për detyrë të inkriminon vehten apo të afërmit e sajë e as të pranon fajësinë, të mbrohet vetë apo përmes ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së sajë si dhe të kundërshton aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave.

Lidhur me këtë e akuzuara ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi të drejtat e sajë mbi të cilat është udhëzuar nga gjyqtari, mbrojtës nuk do të angazhon, mbrojtjen do ta bënë vetë dhe do të përgjigjet në pyetjet e gjykatës.

Pas kësaj gjyqtari i kësaj çështje penale ka ftuar prokurorin e shtetit për të lexuar aktakuzën sipas së cilës është ngarkuar e akuzuara.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe pasi gjyqtari është bindur se e akuzuara i ka kuptuar në tërësi të drejtat e sajë që i takojnë me ligj, se e ka kuptuar edhe aktakuzën, të njëjtës i ka dhënë mundësinë të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e sajë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

E akuzuara V.D. ka deklaruar se e ndjenë vehten fajtores dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se është e vërtetë që me dokumentet e përmendura e ka regjistruar veturën e përmendur në Qendrën e

Regjistrimit të Automjeteve në Shtërpcë por nuk e ka ditur se të njëjtat kanë qenë të falsifikuara. Në fund të deklaratës së sajë ka kërkuar nga gjykata që gjatë matjes së dënimit të ketë parasyshë të gjitha këto fakte dhe rrethana në të cilat është kryer kjo veprë penale dhe t'i shqipton një sanksion penal më të butë këtë pasi që edhe është nënë e një fëmije.

Pas deklarimit të të akuzuarës mbi pranimin e fajësisë, gjyqtari u bind se e akuzuara i ka kuptuar në tërësi natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht dhe është bazuar në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe në provat e prezantuara nga prokurori i shtetit, këtë edhe për arsyen se aktakuza nuk përmbanë ndonjë shkelje ligjore apo gabim teknik, për çka gjyqtari konsideron se pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të KPPRK-së dhe duke u bazuar në të njëjtin nen par.2 gjyqtari ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit Visar Musa, i cili ka deklaruar se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga e akuzuara pasi i njëjti është bërë konform ligjit.

Gjyqtari i çështjes është bindur se janë vërtetuar të gjitha faktet mbi pranimin e fajësisë, kështu që duke u bazuar në nenin 248 par.4 të KPPRK-së ka sjellë aktvendim procedural mbi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe procedurën penale e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe nga provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, gjegjësisht nga librezat e qarkullimit, librezat numër, vërtetimi mbi marrjen e sendeve i dt. 11.11.2014 dhe raporti mbi ekspertizën nga ana e Sektorit për Ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve i dt.20.03.2014, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- se e akuzuara me dt.05.03.2012 në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Shtërpcë-QRA e ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtetë e paraparë të shërbej si provë në një dokument publik, në atë mënyrë që me qëllim që t'i ikë zhdoganimit dhe regjistrimit të rregullt të automjetit të markës "Ford Fiesta" ngjyrë e kuqe, me nr. të karrocërisë, viti i prodhimit 1990, përmes dokumentit të falsifikuar-librezës së qarkullimit të shtetit të Serbisë në emër të sajë të cilin më parë e kishte falsifikuar, ka arritur t'a regjistroj automjetin e sajë në QRA në Shtërpcë edhe pse e ka ditur se të njëjtat dokumente janë të falsifikuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjyqtari gjeti se në veprimet e të akuzuarës kanë ekzistuar të gjitha elementet e veprës penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 të KPK-së, për çka të njëjtën e ka shpallë fajtorë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarën gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e sajë, sjelljen e sajë korrekte në procedurën penale, se e njëjta ka pasë sjellje të mira në të kaluarën dhe nuk është e njohur si përsëritëse e këtyre lloji të veprave

penale apo veprave të ngjashme, si dhe atë se është e martuar dhe nënë e një fëmije për të cilin duhet të kujdeset. Andaj në bazë të këtyre rrethanave gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës të cilën e njëjta e ka kryer dhe pas këtij vlerësimi të akuzuarës i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajshë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së sajë dhe personalitetin e të akuzuarës dhe se me të do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që e akuzuara të mos kryen vepra penale dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 34 të KPK-së.

Konform nenit 60 të KPK-së gjykata të akuzuarës i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, gjegjësisht marrjen e sendit dhe atë dokumentet e falsifikuara – librezën e qarkullimit e Republikës së Serbisë, librezë e qarkullimit numër e Republikës së Kosovës si dhe tabelat e regjistrimit

Konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së të akuzuarën e ka obliguar të që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguan paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË SHTËRPECË
P.nr.144/2015 me datë 21.01.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.